



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-144

Prishtinë, më 10 shkurt 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 SHKURT 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sreten Ivanović dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2014,
2. Vazhdimi i mbledhje s plenare, të filluar më 6 shkurt 2014,
3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2014.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 6 shkurt 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të martën, më 11 shkurt 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina",
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
5. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri",
6. Emërimi i një (1) anëtari në Bordin e RTK-së,
7. Koha për pyetje parlamentare.

3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 13 shkurt 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për sigurimin shëndetësor,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për skemat pensionale të financuara nga Shteti,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014

Kryesia pas diskutimit, propozim-programin e punës së Kuvendit për vitin 2014 e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

2. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia pas diskutimit, propozimin e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës dhe nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e radhës, më 13 shkurt 2014, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar dhe GP 6+ , 1 anëtar.

3. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri: Zenun Pajaziti, Hashim Deshishku, Fikrim Damka dhe Time Kadrijaj, si dhe nga stafi mbështetës i Administratës së Kuvendit, Besim Haliti dhe Ariana Musliu, për të marrë pjesë në Seminarin Parlamentar me temë “Shëndeti dhe Mbrojtja e Konsumatorëve”, i cili do të mbahet në Bruksel prej datës 18-21 shkurt 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, me mundësi rimbursimi nga Parlamenti Evropian.

4. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për Komitetin Parlamentar të Miqësisë Arabi Saudite-Kosovë, që do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës më 7-9 maj 2014

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kuvendin e Republikës së Kosovës të Komitetit Parlamentar të Miqësisë Arabi Saudite-Kosovë prej datës 7-9 maj 2014.

2. Shpenzimet e akomodimit, si dhe shpenzimet tjera të dala shtesë për delegacionin e lartshënuar në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Njoftimi i kryetarëve të komisioneve parlamentare lidhur me vizitën zyrtare, të realizuar në Bruksel prej 15-17 janar 2014

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të realizuar nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Arben Gashi, dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ahmet Isufi, në Bruksel prej 15-17 janar 2014.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*